


# Departamenti për Shërbimet Mbështetëse

**Departamenti Për Shërbimet Mbështetëse eshte strukture qe merret me mbështetjen dhe plotësimin e nevojave te strukturave operacionale me burime njerëzore, materialo-logjistike, financiare dhe me teknologji informatike, nëpërmjet rekrutimit te personelit, planifikimit e shpërndarjes së buxhetit, si dhe nëpërmjet menaxhimit e administrimin e burimeve mbështetëse ne tërësi, me qellim qe te sigurohen kushte optimale pune për shërbimet policore.**

# Drejtoria e Personelit

**DEPARTAMENTI**
**Për Shërbimet Mbështetëse**
Zv/Drejtori i Përgjithshëm (4)

**Drejtoria e Personelit** 15

- 15/1 **Sektori i Karrierës**
- 15/2 Sektori i Organizimit Pagave dhe Pensioneve
- 15/3 Sektori i Administrimit të Dokumentave
- 15/4 Sektori i Rekrutimit
- 15/5 **Qendra Profilaktike dhe e Shëndetit të Policisë**

**Kjo Drejtori ka përgjegjësi për rekrutimin, trajnimin, ecurinë në karrierë, trajtimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e personelit të Policisë së Shtetit në përputhje me legjislacionin shqiptar.**

**Organizon dhe bashkëvepron punën me Departamentet e tjera të Policisë së Shtetit, për përgatitjen e studimeve dhe analizave lidhur me nevojat dhe përbërjen organike të Policisë së Shtetit , përzgjedhjen e punonjësve të policisë për promovinin në gradë, për hartimin e politikave të trajtimit financiar të punonjësve të policisë**



# Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit

DEPARTAMENTI
Për Shërbimet Mbështetëse
Zv/Drejtori i Përgjithshëm 4

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit 16

- 16/1 Sektori i Emergjencave Koordinimit dhe Sallave Operative
- 16/2 Sektori i trajnimeve
- 16/3 Sektori i teknologjisë së informacionit
- 16/4 Qendra e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit



**Misioni i kësaj Drejtorie është studimi, projektimi, implementimi i teknologjive të reja informatike, të ndërlidhjes, telefonisë, pajisjeve informatike në përdorim të Policisë së Shtetit, si dhe të monitorimit e mirëmbajtjes së tyre, me qellim garantimin e menaxhimin total të informacionit policor**

**Qendra e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (IT) e cila kryen asistimin, koordinimin, përgatitjen, propozimin e programeve dhe projekteve të Teknologjisë së Informacionit, standardizimin e teknologjive të reja të rrjetit informatik, të radiondërlidhjes, telefonisë digjitale e analoge dhe të funksionimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve e paisjeve të teknologjisë së informacionit**

# Drejtoria e Buxhetit & Financës

**DEPARTAMENTI**
**Për Shërbimet Mbështetëse**
Zv/Drejtori i Përgjithshëm ④

**Drejtoria e Buxhetit & Financës** 17

- 17/1 **Sektori i Buxhetit & Financës**
- 17/2 **Sektori i Kontabilitet**




**Drejtoria e Buxhetit & Financës ka për mision menaxhimin e burimeve financiare dhe administrimin e vlerave materiale,, ndjekjen e zbatimit të buxhetit të miratuar në nivel artikulli dhe nënartikulli për të gjitha strukturat vartëse, për hartimin e projekt -buxhetit dhe ndjekjen e zbatimit të tij, sipas procedurave ligjore në fuqi.**

# Drejtoria e Programimit dhe Mbështetjes Logjistike

**DEPARTAMENTI**
**Për Shërbimet Mbështetëse**
Zv/Drejtori i Përgjithshëm (4)

**Drejtoria**
**e Programimit dhe Mbështetjes Logjistike** 18

- 18/1 **Sektori Ekonomik**
- 18/2 **Sektori i armatimit**
- 18/3 **Sektori i Autotransportit**
  - 18/6 **Q.R.SH.A. (Qendra e Riparimit dhe Shërbimeve Të Automjeteve)**
- 18/4 **Sektori i Investimeve dhe Menaxhimit të Pronës**
- 18/5 **Q.F.M.T. (Magazina Qëndrore e Policisë së Shtetit**




**Kjo Drejtori ka për mision menaxhimin e shërbimeve mbështetëse,ne struktura qendrore e vendore, per programimin dhe planifikimin sa me real të burimeve, miradministrimin e burimeve ekzistuese dhe krijimin e burimeve të reja në përputhje me kërkesat dhe mundesitë buxhetuese, me qellim krijimin e kushteve optimale për strukturat operacionale.**

# Sektori Ekonomik

**DEPARTAMENTI**
**Për Shërbimet Mbështetëse**
Zv/Drejtori i Përgjithshëm ④

**Sektori Ekonomik për Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë**

**Njësia e Shërbimeve të Mirëmbajtjes**



**Sektori Ekonomik ka për mision sigurimin e plotësimit te nevojave materialo teknike te personelit te Drejtorisë se Përgjithshme te Policisë se Shtetit, identifikimin, planifikimin e zgjidhjen e kërkesave e nevojave te paraqitura, për logjistike e trajtim materialo- ekonomik.**



